



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 496/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Hamit Taç Kosova Turk Birligi (KTB), dega në Mamushë, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Hamit Taç Kosova Turk Birligi (KTB), dega në Mamushë,

Arsyetim

Me datën 04.11.2013, Hamit Taç nga Kosova Turk Birligi (KTB), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendohet se në VV me nr. N0:01 në Komunën e Mamushës është bërë keqpërdorim nga ana e vëzhguesve.

Parashtruesi i ankesës ka pretenduar se është dëshmitar i rastit.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

Ankesa është e pabazuar.

Me nenin 118.4 LZP-sw, parashihet se: *“Mund te apelothen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë pasi që nuk ka prova të mjaftueshme për tu vërtetuar se është bërë keqpërdorim nga ana e vëzhguesve në VV Nr.1 në komunën e Mamushës, prandaj PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 496/2013 më datën 07.11.2013

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala

Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i,*